



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

314/10
Nr. dt. 31.03.2010

Për: Z. Avdi Salihu, Dekan i Fakultetit të Shkencave Teknike të Aplikuar (FSHTA) të Universiteti të Prishtinës

NJOFTIM

Mbështetur në LAL 2/2003 dhe Udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj: UA 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, UA 1/2009 për Akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, dëshiroj t'ju njoftoj se Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim dhe ka vendosur si në vijim:

A. Programet e studimit

1. Makineri industriale – BA
2. Informatikë inxhinierike - BA
3. Teknologji e përpunimit me prerje - MA

akreditohen për një periudhë dy vjeçare në rastin e parë (1 tetor 2010-30 shtator 2012).

Fakulteti është i obliguar që jo më larg se 30 shtator 2010 të hartojë një Plan të përmirësimit të cilësisë në dritën e rekomandimeve të dhëna nga Ekipi vlerësues dhe atë ta dorëzojë në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës e cila do të monitorojë implementimin e atij plani.

Prishtinë, 31.03.2010

Me respekt,
Basri Muja, u.d. Drejtor